

VITI XVI, NUMRI 3 / MARS 2012

FOREVER



HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA



The Last
EUROPEAN RALLY
-The Best
EUROPEAN RALLY



Bëje Mirë Detyrën Tëndë



Sikurse ndodh shpesh në jetën tonë, gjërat e thjeshta praktikisht janë rezultat i një pune dhe investimi të fortë.. mendoni për një çast hapjen e dritave në shtëpinë tuaj. Ne nuk mendohe mi fare, takojmë çelësin dhe presim të ndizet drita. Por mund të keni parë edhe një menaxher me përvojë në Forever kur bën prezantimet. Ata e bëjnë atë të duket aq e lehtë sa ne arrijmë të themi „sa të lehtë e kanë ata”. Ju siguroj se nuk është aq e lehtë sa duket; ai është rezultat i angazhimit të tyre në këtë biznes.

Më shkoi ndër mend kjo ide kur kisha hypur në avion dhe po prisja që ai të ngrihej. Shumica nga ne ka udhëtuar me avion; ai është bërë një mjet shumë i zakonshëm udhëtimi, sa që neve , me të drejtë, na duket një gjë shumë e lehtë.. Por a ju ka shkuar ndonjë herë në mendje të gjykoni, se si ngrihen në ajër mijra avionë, ku kanë hypur qindra njerëz, duke fluturuar me disa qindra kilometra në orë dhe në distanca disa mijra kilometra? Thjesht, të mbahet fryma kur mendon për ato qindra pjesë që lëvizin... , punonjës biletarie, staf i çek-init të biletave, staf i sigurisë dhe i kontrollit të hyrjeve, ekipazh i kabinës e pilota, ekipazh i pistave, administrator të linjave ajrore, mekanikë, përpunues të bagazheve, kontroll e komandim i trafikut ajror, menaxhim i aeroportit, kontroll nga organet shtetërore, shërbime të ushqimit dhe të kujdesit etj.

Por në një farë mënyre në mbarë botën, të gjithë këta bëhen bashkë disa mijra herë në ditë. Kjo mrekulli e kohëve moderne, hap një mundësi të pafund për të zbuluar dhe njohur njeri tjetrin, të bashkohen me njeri tjetrin dhe të bëjnë biznes me njeri tjetrin. A mund ta imagjiloni sa ndryshe do të ishte bota pa udhëtimin ajror? Duke menduar për mrekullinë e udhëtimit ajror, në udhëtimin e fundit isha ulur në sedilje dhe po shikoja shiun që binte, si dhe lëvizjet e shpejta të personelit të pistës ku secili bënte detyrën e vet për përgatitjen e avionit për ngritje. Gjatë këtij momenti, më tërhoqi vëmendjen e veçantë një zonjushë, që dukej se kish një detyrë më të vecantë nga të tjerët. Ajo ishte një vajzë e re e mbështjellur që duke luftuar me të ftohtin, duke ngarkuar bagazhet nga transportieri në konvejerin e avionit prapë buzëqeshte. Ajo punonte fort dhe shpejtë, nuk nervozohej apo ti hidhte rrëmujë por ajo i vendoste me kujdes bagazhet në rripin e konvejerit. Të shumtën e kohës ajo punonte vetëm, por herë herë dilte ndonjë baulle shumë e rëndë. Pa hezituar ajo i drejtohej një kolegu të saj, ai vinte shpejt dhe e ngrinin bashkë. E vreja gjatë këtij veprim të saj. Dukej se nuk i ankoheshin ose i bërtisnin njeri tjetrit por punonin në grup. Ajo kërkonte ndihmë vetëm kur kishte nevojë që nuk e ngrinte dot dhe kolegu i përgjigjej shpejt pa e harruar as detyrën e tij. Ishte mjaftë frymëzuese të shikoje këtë punë në grup. Unë e kuptoj se detyrat nuk ishin shumë të komplikuar dhe nga kjo pikpamja puna e tyre mund të duket pa shumë rëndësi, por ai avion nuk mund të ngrihej pa u ngarkuar edhe bagazhi i fundit. Besoj se ata nuk e vrisnin mendjen se kush i shikonte ose në se vërtet i shikonte njeri. Ata vetëm bënin detyrën e tyre ashtu siç e kishin mësuar.

Arkitekti skocez, John Allen në një nga ndërtimet e tij shkroi: "Kushdo qofsh ti, bëje mirë pjesën tëndë". Dhe po më lejoni, do të doja të bëja një paralele me çka të gjithë ne bëjmë në Forever:

1. Ne shpesh nuk e njohim rëndësinë tonë në skemën e madhe të gjërave. Ne dëgjojmë vetëdëshimin dhe pamundësinë e imagjinuar, ne shpesh themi: „Unë jam thjesht një Asistent Menaxher”. Flakini tej këto supozime të pakuptimta, për vete dhe për të tjerët. Në qoftë se ajo vajza e pistës nuk do bënte detyrën e saj, avioni nuk do ngrihej në kohë.
2. Ka momente kur puna të duket monotone. Të ngarkosh e shkarkosh çdo ditë valixhe mund të jetë e lodhshme dhe e mërzitshme. Po kështu mund të duket të shkosh të takohesh me njerzit për prezantim apo të nxjerrësh e të shikosh here pas here listën emërore që ke bërë. Egjithë kjo mund të duket si një takim ordiner, por mos harro se ke njerëz që këtë gjë e kanë dëgjuar për herë të parë, përpiqu që në çdo rast të jesh më i miri i vetvetes. Si ajo vajza e pistës, që çdo valixhe e vendoste sikur të ishte e saja.
3. Ku një baulle është shumë e rëndë dhe nuk e ngre dot vetëm, pranoje atë dhe kërko ndihmë. Mos e lodh veten shumë duke u përpjekur të bësh shumë. Edhe në këtë biznes do të hasësh situata që nuk i ke parashikuar ose për të cilat nuk ke qënë i përgatitur. Mos të të prihen krahët; kërko ndihmën e sponsorve lart, kolegëve poshtë apo paralel. Edhe në qoftë se të kërkojnë ty ndihmë, jepen atë. Pikërisht si kolegu i asaj vajzës të pistës që nuk ngrinte dot valixhet e rënda.
4. Bëje mirë pjesën që të takon. Qëndro i fokusuar dhe i angazhuar për arritjen e objektivit tënd. Mund të jetë objektiv për Eagle menaxher, fitimi i pjesmarrjes në Global Rally, cilido qoftë objektiv, qëndro i fokusuar. Ngarko „bagazhet” e këtij avionit dhe nisu për tek tjetri.
5. Mos e ki mendjen se kush të shikon. Vetëm përcakto qartë „PSENË” tënde dhe ngjitju asaj. Të kesh motivim është me rëndësi jetike, por ti duhet të shtyesh nga një dëshirë e brëndshme, kjo është ajo që ne e quajmë „PSE-ja”.
6. Mbi gjithshka tjetër kënaqu për vete. Edhe në shiun e rrëmbyeshëm, apo përballë pengesave ji buzëqeshur dhe ruaje atë me krenari.

Do të doja ta gjeja atë vajzën e pistës dhe ta bëja pjesë të Foreverit. Unë e di se ajo do të kërcente nga gëzimi për këtë mundësi dhe ndoshta një ditë do të parakalonte në skenë si diamante. Unë mund të mos e takoj atë kurrë, por unë ju premtoj : Unë kurrë nuk do të pushoj së kërkuari, dhe as ju nuk duhet të pushoni së kërkuarit!

Rex Maughan
REX MAUGHAN
I JUAJI PËR JETË



Liria



Marsi është muaji i përtëritjes në të gjitha fushat. Ringjallet natyra, ndejmë aromën e pranverës, bota bëhet më e buzqeshur, zbukurohet mjedisi përreth. Nga pikpamja historike, Marsi në rajonin tonë solli revolucionet, luftën për liri: lirinë e popujve.

Në kuptimin e sotëm, formulimi i lirisë është zgjeruar shumë, i përket edhe lirisë tonë për të drejtën, për një jetë të shëndetshme dhe me pavarësi materiale.

Ç'mund të bëjmë, që të jetojmë nivelin më të lartë të lirisë?

Së pari duhet të njohim shijen e lirisë. deri sa nuk e njohim atë shije, nuk e dimë përse bëhet fjalë? Duhet ta ndjesh ç'do të thotë të jesh i lirë dhe i pavarur nga të tjerët, nga mendimet dhe vullneti i të tjerëve. As materialisht, as moralisht nuk mund të varesh nga ata që nuk i simpatizon.

A shkon me qejf në vëndin e punës tënde, e ke qejf atë punë që bën, e do shefin tënd dhe a e merr shpërblimin e duhur të punës tënde? Të pëlqen të punosh jashtë orarit? Të pëlqen që të të thërrasin të punosh edhe për fund jave, dhe a je i kënaqur me veten, me gjëndjen tënde shëndetsore, me pamjen tënde, me formën tënde dhe me fytyrën tënde? Në qoftë se ndërmjet këtyre, qoftë edhe një pyetje të vetme nuk i përgjigjesh, atëhere çfarë pavarësie ke?

Fillo të mendosh për këtë, dhe pranoje ofertën e bashkpunëtorëve tanë, që të të shoqërojnë në një Botë të Re, në Botën Forever.

Kjo është një botë reale, jo një botë e krijuar nga media, por një botë që qëndron mbi themele ekonomike gurësh të fortë 34 vjeçar, në një sistem që ndihmon strukturimin e sipërmarrjes tënde, dhe që zhvillon personalitetin tënd.

Do të doje ti fshije jo-të nga jeta jote? Në qoftë se po, atëhere bisedo me sponsorin tënd apo me linjën tënde të sipërme, kërko këshillën dhe ndihmën e tyre, pyet si mund të fitohet liria e vërtetë personale.

Më 1848-49 revolucionarëve ju desh të luftonin me armë për lirinë. Sot falë Zotit gati çdo vend i botës është i lirë, tashmë ty të duhet të zhvillosh luftën për liri vetëm me Vetën tënde, që në fund të mund të fitosh shpërblimin që meritojnë fitimtarët.

Përpara FLP!

DR. SÁNDOR MILESZ
DREJTOR I PËRGJITHSHËM



EUROPEAN RALLY *be free*
BUDAPEST 2012



FESTA E ÇEQEVETË MËDHENJ DITA E I-RË

E pritëm një vit këtë ditë, dita e Rally-it të fundit europian, ku në historinë e këtyre takimeve, mikpritësi për të tretën herë është Budapesti. Njëri sy na qan, tjetri na qesh, sado që në skenë ka hare: na vjen keq se mbaron një epokë, por ndërkohë edhe gëzohemi sepse Hawaii pret në vitin 2013 të kualifikuarit e këtij aktiviteti.

Gjatë 12 vjetëve në Rally-in European kanë marrë pjesë 96 mijë vetë. Takimin e parë të Londrës e pasuan Kopenhaga, Nizza, Stikholmi, Vjena dhe qytete të tjera. Budapesti është për të trtën herë vendi i zhvillimit të këtij aktiviteti: në 2003, në 2008 dhe ja prap tani. Në mbarë botën 17 mijë vetë kanë përfituar nga programi Profit Sharing me gjithsejt 3858 ngritje niveli. Drejtuesit e firmës vetëm vitin që shkoi ndanë për të kualifikuarit 80 milionë Euro. Vallë pas kësaj sa mund të llogariten si aksionerë të fund vitit? Në fund të ditës së dytë edhe kjo bëhet e qartë.

Trupa elegante të veshura me të bardha, zbresin nga lartësia nën rrathët e dritave të mëndafshhta mbi skenë dhe të muzikës emocionale, takimi i Rally-it european të Forever Living fillon me shfaqje akrobatike. Ky rast është një nga aktivitetet më të rëndësishme të firmës; çdo vit një herë vendet e kontinentit takojnë njeri tjetrin që të bëjnë bilancin e vitit që shkoi dhe të shikojnë për atë që vjen. Megjithatë Rally European është më shumë se një takim: Përveç fjalëve vlerësuese dhe nxitëse, distributorët këtu marrin vlerësimin dhe shpërblimin e veçantë të vitit që shkoi, marrin çeqet e tyre të programit Profit Sharing . Falë sistemit të marketingut në FLP ka shumë mënyra për tu zhvilluar nga pikpamja e biznesit. Për rezultatet mos rri në radhë një herë të vetme, sepse ecjen përpara ta shpërblejnë në shumë aspekte. produktivitet i xhiros, rritje e grupeve, numur i menaxherëve të rinj, zhvillim i matur me periudhën paraprirëse: të gjitha llogariten dhe gjithshka një mundësi e veçantë që bashkpunëtorët të bëhen pjesë e një vlerësimi. Në programet stimuluuese mund të përfshihet kushdo me përkushtimin e duhur një vjeçar, pamvarsisht nga rezultatet e mëparshme. Nga viti në vit dalin rezultate befasuese, edhe me një vit mund të bëhen hapa të fuqishme përpara. Kjo nuk është vetëm betejë e individit, këtu janë në garë edhe shtetet e rajonet. Por ajo që është esenciale:





jemi pranë njeri tjetrit, nuk jemi kundër njëri tjetrit dhe madje këtë tregon Rally European dhe programi Profit Sharing që është kulmi i tij, që për rezultate të nivelit ndërkombtar se si mund të bëhet pjesë kushdo, që në vëndin e vet ka drejtuar shkëlqyeshëm grupet e tij. Po kështu FLP në një mënyrë krejt të veçantë, një pjesë të rëndësishme të fitimit e rindan me më të mirët. Se sa dhe kujt do ti takojë kjo pjesë, ajo mësohet në çastin e dorëzimit të çekut në skenë. Një çek me vlera të mëdha që arrin edhe disa qindra mijë euro, përveç bonusit mujor, është një dhuratë e vërtetë.

Një nga elementët më emocionues të Rally-it European është thirrja në podiumin e skenës të menaxherëve të kualifikuar për Profit Sharing, të ndarë në disa grupe, sipas radhëve ku shumat që jepen vijnë në ngjitje. Por edhe ai që akoma nuk është në këtë nivel edhe ai mund të ngjitet në skenë, sepse puna vlerësohet në shumë mënyra: kështu falnderohen ata që janë bërë pjesë e rëndësishme e programit 2 ditor apo që kanë realizuar shumë pikë. Festojnë Senior menaxherët që kanë sponsorizuar personalisht nga 2 menaxherë, Soaring menaxherët që kanë front 5 menaxherë, dhe Zafir menaxherët që kanë 9 menaxherë në linjën direkte, madje edhe 2 menaxherë Diamant-Zafir (që kanë sponsorizuar personalisht nga 17 menaxherë) Shpërblehen menaxherët Eagle, më të mirët e distributorëve që kanë arritur më parë nivelin e menaxherit.

Tashmë të premtën paradite në pallatin e sportit „Papp László”. Trupat e shteteve e ndejnë se këtë bashkim duhet ta shprehin në një mënyrë, dhe për këtë i ndihmon Foreveri, ku çdo vit jep çmimin Spirit Award, atij grupi që ka një entuziazëm dhe frymëzim më të madh dhe që krijon atmosferën më gazmore. Dhe kështu të gjitha skuadrat bëjnë gjithshka për të tërhequr vëmendjen e zhurisë që edhe këtë vit të jenë më të mirët, ku shohim veshje trupash njëra më e mira se tjetra.. Shtetet e Benelux-it paraqiten me jelek ngjyrë të verdhë portokalli të ndërtuesve të rrugëve, Skandinavia na verbon me ar dhe argjend, ndërsa francezët mund ti njohim që nga larg nga jelekët e tyre ngjyrë të verdhë kanarine. Hungarezët me të bardha elegante, duke plotësuar kështu ngjyrat kombëtare. Por çmimi Spirit Awards nuk nënkupton vetëm pamjen e jashtme por merr parasysh edhe aktivitetin: çdo skuadër është e përgatitur me performanca të gatshme, me llampa





ndriçimi, me flamuj të mëdhenj dhe me vallzime, Arena është kthyer në një fushë loje festive dhe ahengu ku fliten shumë gjuhë. Dramaturgjia e rally-it të Budapestit i fton pjemarrësit në botën e cirkut: pas numurit artistik të fillimit të programit në skenë shfaqet silueta e themeluesit të firmës, legjendës së gjallë, **Rex Maughan**. Si kreu i familjes së madhe ndërkombtare, i përshëndet të gjithë me shikimin dhe lëvizjen e duarve të tij, dhe **Aidan O'Hare**, zëvendës presidenti për Europën, duke shoqëruar atë na përshëndet edhe me fjalë.

Eshtë një rast i vecantë ky i sotmi në historinë e takimeve rally, sepse në këtë formë organizohet për herë të fundit. Në vend të takimeve bazë kontinenti, në të ardhmen kualifikimet do të bëhen në program të rangut botëror. Hungaria mori rolin dekorues, sepse Budapesti organizon për herë të fundit këtë takim shetitës. „Ky është Rally i fundit europian – thotë Aidan O'Hare. – Ishte një program shumë i mirë, por duhet të ecim më tej drejt takimeve rally globale.”

Aidan O'Hare përmbledh stacionet më të rëndësishme të viteve të shkuara, pastaj falnderon mikpritësit për punën organizuese, dhe me këtë i jep fjalën drejtorit të rajonit të Hungarisë dhe Ballkanit, **Dr Sándor Milesz**; programimi i kohës është shumë i rëndësishëm për ne sepse ajo është shumë e shtrenjtë, dhe duhet të kemi kujdes përse e përdorim.

Supervisor – fillimi, menaxher – shkalla e parë e lirë, e kështu më tej deri tek diamanti, të provojmë ti ngjitem sa më shpejt nivelet, sepse në këtë punë nuk ka asnjëherë stacion të fundit, por gjithnjë vjen një sfidë e re.

Drejtori i përgjithshëm dhe kolegët e tij sjellin në podiumin e skenës një tortë të madhe, sepse festohet 34 vjetori i FLP, 15 vjetori i saj në Hungari dhe mbahet rally i 12-të europian. Dhe nga kjo tortë siç e ka karakteristikë kjo firmë u takon nga një copë të gjithëve. 15 mijë pjesmarrës në stadium brohorasin Happy Birthday dhe mijra të tjerë brohorasin duke e ndjekur atë përmes internetit.

Zëvendës presidenti na thotë se gjatë 2 ditëve do të ndahen 150 çeqe dhe Aidan O'Hare thërret në skenë **Gregg Maughanin**, që si i biri themeluesit të kësaj firme Rex Maughan, për 15 vjet, ai vetë ka përshkuar Europën për të lidhur sa më shumë





vende me këtë ndërtim rrjetesh. „ndërsa tani fillojmë punën dhe kemi shumë punë për të bërë, sepse do të bëhet vlerësimi i 22 vendeve” – thotë zëvendës presidenti, pastaj parakalojnë grupet e përfaqësuesve të vendeve me flamujt e shpalosur dhe të shoqëruar nga muzika karakteristike.

Prezantohen edhe drejtuesit e programit: **Dr. Renata Steiner** - senior menaxhere dhe menaxheri **Peter Boots** , drejtor i pergjithshëm i vendeve të Benelux thërret në skenë raundin e parë të konkursit të bukurisë Sonya. Vlerësim i markës kozmetike Forever, i aromës e Sonya mund të shfaqet kudo, të paktën tek rrjetndërtuesit aktivë që janë në nivelin e supervizorit, i cili përfaqson në mënyrë të natyrshme bukurinë. Gjatë ditës zonjushat demostrojnë disa herë, dhe vetëm në fund të ditës do të shpallet fituesja.

Si pikë pasuese e programit është tregimi i rrugës së tyre nga **Paddy dhe Pauline Keegan**, çifti i distributorëve numur një nga Irlanda. Sikurse tregojnë vetë, kur kishin humbur shtëpinë dhe makinat e tyre, kur takuan Regin ju përveshën këtij biznesi. „Nuk kishim asgjë, por pastaj erdhi FLP dhe për dy vjet u bëmë Soering menaxherë-tregojnë ata. Jo vetëm punojnë mirë, por gjithnjë e më mirë, sepse zhvillimi është një vlerë e rëndësishme në këtë biznes. „Nga FLP mësuam një stil jetese krejt të ri. Arritëm deri aty sa të shkonim në provincë dhe tani kemi shtëpinë tonë të madhe e të bukur dhe një Mercedes të ri – thotë Pauline. -E adhuroj këtë firmë, sepse na dha mundësi të bënim shumë për fëmijët tanë dhe për veten tonë. Kisha 30 vjetë me një qëllim, të shikoja delfinët në Bahama. Do të doja të besonit edhe jut ë gjithë mund ta bëni këtë gjë sepse produktet e FLP janë si një „Rolls Royce” , vetë u besoni atyre. Eshtë një firmë e mrekullueshme që e dua me pasion dhe këtë pasion dua tia përcjell kujtëdo.” „Kemi filluar të ëndërrojmë që nga 1978, shumë ndryshime kemi bërë, por atëhere shumica nuk e njihnin sistemin MLM. „ merr fjalën Paddy Keegan. – Tashmë e pamë se kjo do të jetë rruga për të ardhmen , mjeti më i thjeshtë





për të siguruar të ardhura plotësuese. Këtu gjithnjë mund të vendosim në se duam të punojmë, dhe në qoftë se po, me kë do të punojmë. Në qoftë se kini besim, gjatë disa viteve mund të ndryshoni jetën tuaj. Në qoftë se ne ia arritëm edhe ju do tia arrini. Mund të arrihet pavarësia financiare; për këtë duhen disa vite punë. Filloni të ëndërroni ku do të arrini pas 5 vjetësh. Mbështetni bashkëshortët tuaj dhe me siguri atëhere në moshën 70 vjeç pensioni juaj do të jetë i sigurtë. Në Forever sot ka mundësi shumë më të mëdha sepse jemi bërë globalë.”

Këtu Paddy Keegan e ka fjalën për programin stimulues Profit Sharing 2.0, ku nuk do të ketë më kufij artificialë.

Serinë e bisedave të mbajtura e ndërpret sistematikisht përshëndetja e nga një të kualifikuari: të sapo pjekurit Eagle menaxherë marrin vlerësimet e tyre.

Lektori që pason është Soaring menaxheri **Andy Waring**, i cili në radhë të parë thekson që të mos ndalosh papritur nga efekti i ndonjë rezultati, por të ecim më tej në realizimin e planit të biznesit: „Edhe atya që janë në majë bëjnë përpjekje për ata që janë poshtë tyre sepse është interesin e tyre” – shpjegon ai. Për atë nivel Eagle është një lloj garancie për sigurimin e të ardhurave si dhe një urë për të kaluar në nivelin e diamantëve. „Ishte një rrugë e gjatë deri atje” – thotë ai, „prej këndeje vetëm një hap i vogël duhet për të marrë edhe fitime të mëdha. Gjithkush e vendos vetë, që pikërisht sivjet do të arrij nivelin Eagle, dhe atëhere mund të vijë me ne në Sardenjë.” – duke ju referuar shpërblyerit me pushime në Sardenjë të atyre që kanë arritur eagle menaxherë.

Grupi artistëve të parë në hapje, tashmë gjatë ditës është rikthyer disa herë, prej tyre mund të shohim numura force dhe saltoje: pikërisht rezistencë, përpikmëri, vullnet dhe energji.

Pas turit të dytë të konkursit të bukurisë të veshura me fustane mbrëmjeje, pason produksioni Diamant menaxheri hungarez **Miklos Berkics** dhe i shokëve të tij; një këngë të njohur na këndojnë **Klára Hertelendy, Diána Fittler dhe András Bánhidly**,





ndërkohë në sfond qëndrojnë anëtarët e skuadrës së tyre me nga një flamur kombëtar europian dhe nuk na duhet të presim shumë se kush do të jetë më e bukura në FLP europiane. Është polakja Sylwia Ignaszewska që fiton konkursin Sonya.

Pas kualifikimit të tjera, **Gregg Maughan**, president i Forever Living Products, flet për fillimet. Për atë kur ndamë për herë të parë bonuset në Rumani, kur pionerët filluan në Skandinavi, kur hapën furnizimet e para... „Shikoni ku jemi tani. Në takimin e parë ishin vetëm 150 vetë, sot 10 mijë vetë. Thjeshtë është e pabesueshme. Kam shkuar në shumë vende, por kujtimet më të bukura kam për Hungarinë. Shumë gjëra të bukura mund të rikujtoj. Pak të mërzhitur që i japim fund serisë të takimeve rally europiane, por gjithmonë kemi provuar të bëjmë diçka më të mirë. Mua tashmë më frymëzon epoka e re dhe sigurisht Hawaii, premtimi i takimit të ardhshëm botëror. Foreveri është një firmë e mrekullueshme, jemi njerëz të mirë, bëjmë gjëra të mira, por kjo nuk mjafton. Nga të mirë duhet të bëhemi të mëdhenj. Të mos e harrojmë këtë fjalë: të mirë ndryshe kurrë nuk mund të bëhemi të mëdhenj. Kjo dëshirë të djegë brënda jush dhe të mos nalemi para asgjëje! Për këtë në radhë të parë duhet të bashkveprojmë me njerzit e duhur, me ata të cilët kanë të njëjtat dëshira si tonat, megjithëse ndonjëherë duhet kohë për ti gjetur ata. Duhet të mësojmë të jemi përsëri fëmijë. Fëmija nuk ka frikë, është krijues dhe është i aftë të dojë. Nuk she kufizime, për të nuk ka kufij. Objektivi ynë të jetë: vetëm të ecim dhe të pushtojmë teritor. Fëmijve u pëlqen ajo që bëjnë. Po ju e doni Foreverin? Në qoftë se po, atëherë shkoni dhe ua prezantoni atë njerzve! Në 2013 të jeni atje në Hawaii, në Rally-in Global.

Gregg Maughan ia jep fjalën **Aidan O'Hare**, që vazhdon me kualifikimet për profit Sharing. Në shoqërimin e rrahjeve të dauleve, befasisht zbulohet seria e shifrave magjepsëse, duke mbrtur tek vlera me 7 shifra dhe ku është fundi! Meqënëse të gjitha këto ishin vetëm pjesë e aktivitetit të ditës së parë të këtij rally të fundit europian, përshkrimi ynë do të vazhdojë në faqet e revistës të Prillit.



FROM GOOD TO BE GREAT

Drejtuesit e Foreverit, **Rex Maughan, Gregg Maughan, Aidan O'Hare, Steve Hatchett**, drejtori operacional i Europës Yves Hamon dhe me prezencën e të gjithë drejtorave të përgjithshëm të vendeve të Europës, në një atmosferë të ngrohtë dhe plot profesionalizëm të konferencës të drejtorave që u zhvillua në një nga sallat e vecanta të hotel Kempinski. **Rex Maughan, Gregg Maughan, Aidan O'Hare, Steve Hatchett, Yves Hamon, Bob Parker, Peter Boots, Ulf Oscarson** bënë një prezantim motivues të jashtzakonshëm. Një nga temat qëndrore ishte ajo e katër gurëve të themelit të suksesit: mënyra e rekrutimit, qëndrimi, zhvillimi dhe rendimenti. Do të donim të krenoheshim me sa më shumë të kualifikuar për menaxherë Eagle, për Profit Sharing, Global Rally e Holiday Rally dhe së bashku të festojmë në një vend edhe më të veçantë me slloganin e 2012: nga të mirë të bëhemi të mrekullueshëm
- "FROM GOOD TO BE GREAT"!



Këtë xhaketë-pasqyrë të veçantë **Rex Maughan** e veshi në hapjen e Europa Rally-t të fundit, në Budapest. Prandaj ka vlerë, sepse përfaqëson përkujtimin e Forever-it. Me shumën që do të dalë nga ankandi, do të përkrahim fëmijët në nevojë nëpërmjet fondacionit Forever Giving

Le të tregojmë, se si është në të vërtetë gadishmëria e Forever-it për të ndihmuar, dashuria e Forever-it! Le të ndihmojmë fëmijët që vuajnë në të gjithë botën!

Faleminderit!

Aidan O'Hare
Nënpresident për Europën



XHAKETËN-
PASQYRË DO TA
NXJERIM NË ANKAND NË
DITËN E SUKSESIT QË DO
MBAHET NË PRILL.
Çmimi i fillimit:
300 euro.



2011

HISTORIA E FOREVER-IT NË SHIFRA PËR 2011-ËN



ITALY ITALI – ndërtes e re për zyrën e FLP



MONGOLIA



shtet i ri që u fut në Forever

MONGOLIA



Në DALLAS përsëri xhirime për serialin e ri të Southfork Ranch-it



CAMBODIA
KAMBOXHIA

ndërtesë e re për zyrën e FLP



Restaurime të jetimoreve në NIGERI



Në çantë kemi akoma më shumë, m.q.se. fluturojmë më tej!

- Forever-i është i pranishëm në mbi **150** shtete
- **5 milion** vetë vizitojnë faqen e internetit Forever Living.com
- Në Republikën Dominikane u shtuam me **250** hektar plantacion të ri me aloe vera dhe me një fabrikë të re përpunimi
- Aloe Vera of America prodhoi **36.900.000 litra** aloe
- Me faqen tonë të Facebook-ut janë lidhur **100.000** vetë
- FLP-ja e ka zgjeruar ofertën me **12** produkte të reja, si dhe me perfeksionimin e mëtejshëm të produkteve
- Shuma e Profit Share-it ishte më shumë se **18.500.000 USD**
- Programi i ndihmës Forever Giving pati efekt për jetët e mijra vetëve në Japoni, Brazil dhe Nigeri
- Forever Nutraceutical prodhoi **702.444.806** tableta, 40 % më shumë, se në 2010-ën



Në botë xhirua vjetore u rrit me

3%

be free
FOREVER

Success Day

BEOGRAD 28.1.2012


Cdo fillim është i vështirë por jo për ne. Viti i ri sjell objektiva, angazhime dhe suksese të reja! Parakalimi në skenë i menaxherëve ishte një hyrje e shkëlqyer e programit, pas të cilit **Branislav Rajić**, drejtori rajonal i Serbisë theksoi se madhështia e firmës tonë fshihet në orientimin e saj global dhe në unifikimin e tregut të saj botëror, në mundësitë e reja të biznesit, në programet e shumta stimuluese, përveç pagimit sistematik të bonuseve.

Angazhim i vitit të ri për anëtarët e Klubit të Presidentit do të thotë që ne duhet të punojmë si flamurtarë. Anëtarët e rinj të Klubit të Presidentit janë: **Jovanka dhe Radivoj Štrboja, Nevenka dhe Vladimir Jakupak, dr. Olivera dhe Ivan Miškić, Irena dhe Goran Dragojević, Dragana dhe Miloš Janović, dr. Marija Ratković, Marija dhe Boško Buruš, Veronika dhe Stevan Lomjanski.**

Si distributorët më të sukseshëm të vitit 2011, **Veronika dhe Stevan Lomjanski** u bënë menaxher diamantë.

Forca e Foreverit qëndron në atë që objektivat tona bëhen vepra shumë shpejt dhe në mënyrë të suksesshme. Objektivi i shprehur hapur lehtëson shumë gjithë procesin deri në realizimin e plotë të tij.

Duhet guxim i madh që premtimet tona ti shprehim hapur para shumë njerzve. **Dr Sándor Mílesz**, përmbledh objektivat dhe angazhimet e reja që duhen plotësuar këtë vit nga FLP e Hungarisë dhe e vendeve të Ballkanit.



Nevenka dhe Vladimir Jakupak, si pionerë të FLP tashmë që nga dita e parë e vitit kanë filluar si rrjetndertues të vërtetë me një numur bashkpunëtorësh dhe me rrjet të zgjeruar. Pjesë organike e jetës sonë është edhe magjika dhe disa herë mjeshtrit e magjive na ndihmojnë që të kalojmë nga realiteti në botën e endërrave, por edhe për atë që shpejt të rikthehemi tek jeta e përditshme. Miku i madh i firmës tonë, zhongleri **Igor Trifunov** na magjeps përsëri me demonstrimet e tij, sidomos atëhere kur nga një copë letër e mbështjellur nxjerr një prodhim të ri të FLP, Immublendin.



Pikërisht për këto produkte foli menaxheri **Siniša Blašković**. Shpresojmë që sivjet dhe në vitet e ardhshme nëpërmjet tyre të kemi disa përvoja të mira.

Për problemet e shëndetit, mendohemi vetëm atëhere kur na bëhen aktuale. Në lidhje me shtyllën kurrizore të njeriut dëgjojmë me dëshirë këshillat që lidhen me qëndrimin, me ecjen dhe me mënyrën si punojmë. Falnderojmë për leksionin e shkëlqyer doktorin dhe fizioterapistin **Dr Predrag Lazarević** – soaring menaxher.

Përvojat e fituara gjatë përdorimit të produkteve janë prova më e sigurtë për cilësinë e tyre të mirë. Ato i përdorin të gjitha moshat. Këtë na i vërtetoi edhe **dr. Dušica Tumbas** që drejtoi bllokun që bën fjalë për përvojën e mjekëve dhe të perdoruesve.

Në podiumin e skenës të Qendrës të Sindikatave u titulluan supervizorët dhe asistent menaxherët e rinj. Kanë bërë një punë të madhe gjatë muajve të kaluar dhe i meritojnë nivelet e arritura. Shpresojmë, që në takimin e ardhshëm ti shikojmë ata në nivele më të larta.



Shënjë dalluese e kulturës popullore është edhe muzika popullore. Në këtë lloj, ambasadore e vërtetë është **Biljana Kristić** dhe grupi shoqëruar Bistrik. E zbkuruan edhe më tepër këtë takim të dimrit në Beograd.

Dita e Suksesit, si takim është edhe një pasqyrë e firmës tonë. Në raste të tilla kemi rastin të dëgjojmë të tillë lektorë, që janë kompetent në profesionin e tyre, mund të ndajmë informacionet më të reja, dhe mund të percaktojmë objektiva të reja, për arrijten e të cilave do të punojmë në muajt e ardhshëm. Por krahas dëgjimit dhe mbajtjes të shënimeve, janë të nevojshme veprat, motivimi dhe shëmbulli personal – na jep si mesazh senior menaxherja **Marica Kalajdžić**.

A i jemi përveshur vetë punës? Se shprehjet „është krizë, nuk kap ara, askush nuk do të regjistrohet”, janë vetëm justifikime! Edhe ti kështu mendon? Mendimet dhe idetë sjellin rezultate pozitive! Të gjithë ëndërrojmë për një karrierë të sukseshme, por nuk dimë si ta realizojmë atë. Dëshira lind veprimin, dhe veprimi sjell rezultatin – na thotë menaxherja **Jovanka Štrboja** Vëm kështu do të bëhemi ai që mendojmë!

Asistent supervizorët tanë të rinj kanë bërë një hap të madh përpara. Ju është dhënë mundësia që të bëhen pjesë e një sistemi marketingu global!

Ku është e fshehta e menaxherëve? Një skuadër është aq e fortë sa anëtarë ka plot me objektiva dhe ëndërra të mëdha. Tek çdo njeri nga ne fshihet një një menaxher i ri. Ajo që kërkojmë, është një mekanizëm i një lloji tjetër që ecën pas nesh! **Mirjana Mičić** – senior menaxhere, me këto metoda i ka kërkuar menaxherët dhe më në fund ata e gjetën atë. Faleminderit Marjanes dhe skuadrës së saj për demonstrimin e shkëlqyer në podium dhe për zgjerimin pa egoizëm të rrjetit të marketingut.

Takimi i ardhshëm do të mbahet më 24 Mars në Qendrën e Sindikatave.

Branislav Rajić
Drejtor Rajonal
i Forever Living Products Serbi





SZILÁRD FEKETE DHE SZILÁRDNÉ FEKETE MENAXHERË

Familja jeton në Miskolc, Istváni punon si inxhinjer informatike, në sferën e konkurrencës, në kohën e lirë i bie daulles në grupin muzikor Deezel. Márta punon si drejtuese e zyrës tek István Holmi. Djali i tyre Márku 19 vjeçar dhe vajza Csenge 16 vjeçare , që të dy mësojnë. Szilárdi na tregoi historinë e dhjetë vjetëve të fundit.

Sponsorët: István Halmi dhe Rita Mikola Halminé. Fronti i sipërm: Terézia Herman , Zoltán Becz, Zsófia Gergely, Aranka Vágási dhe András Kovács, Miklós Berkics, József Szabó, Rex Maughan

Biznesin do ta kesh ASHTU SIÇ E MERITON

Si u futët në lidhje me Forever-in?

Vajza jonë Csenge në vegjëli kollitej shumë. Márta shkoi në farmaci për të siguruar ilaçin aktual. Në një rast të tillë pothuaj gjysmën e farmacisë e uli nga raftet me farmacisten, sepse donte të dinte gjithshka për produktet kundër kollës, praktikisht e bllokoi rradhën. Disa njerëz më tej qëndronte Istváni (*István Halmi, sponsor i më vonshëm – red.*), i cili i foli Mártit, iu prezantua, dhe e ftoi në një prezantim. Kështu u bëmë para disa vitesh konsumatorë, dhe produktet vërtetuan në mënyrë të panumërt efektet e tyre pozitive. Istváni provoi të na drejtonte edhe nga biznesi, na ftoi për informacione, por këtu nuk shkuam shpesh, gjithmonë dilte diçka, që e mbanim më të rëndësishme.

Si ndryshoi ky qëndrim?

Para disa vjetësh një mik më ftoi për një bisedë, më tha, që do të bëhet fjalë për shëndetin, ushqimin. Që të dy shkuam, atje një i ri na foli për produktet dhe mundësit e biznesit të

Forever-it. Sytë më shkëlqyen, dhe thashë me vete, që unë jam pjesë e kësaj. Atëhere e kuptova, që produktet nuk ka nevojë ti shpërndash nëpër shtëpi apo të jesh agjent shitës, por secili ble për veten e tij. Në fund të informacionit lektori kërkoi reagimin ndaj atyre që tha më parë. I treguam që prej vitesh i përdorim produktet. I thamë që sponzori ynë është István Holmi, për këtë na pyeti përsëri: dhe ti nuk ndërton biznesin? Atëhere e morra vesh, që deri tani diçka e kam kuptuar shumë gabim në lidhje me Forever-in. Shkuam në shtëpi, dhe e morra menjëherë në telefon Istvánin. Kjo ndodhi në 2008-ën, atëhere filluam të punonim.

Kush ishte hapi i mëtejshëm?

Në atë fundjavë pati një program Start, në të cilin shkuam, dhe atje Istváni njoftoi një objektiv: ai që do të arrijë nivelin e supervisorit brenda një kufiri kohor të caktuar, ai do të fitoi nga grupi pushime në Greqi. Márta i adhuron udhëtimet, kështu që qe edhe motivimi për nisjen.

Pas disa javësh Istváni dhe Rita ikën në Greqi për të siguruar strehimin, bile sollën edhe foto me kornizë nga dhomat ku do të rrinim. Atëhere kishte vetëm shtatëmbëdhjet ditë nga kufiri kohor, dhe ne po aq pikë na mungonin për tek niveli i supervizorit. Vetëm një pikë në ditë duhet, tha Istváni, dhe kështu u bë, në fund të muajit e realizuam punën.

Si u ndërtua më tej biznesi?

Në 2009-ën u bëmë assistant manager-ë, atëhere „ndaluum” pak. Ashtu siç thotë Attila Gidófalvi, një „jetë relativisht e rehatëshme” ju merr mundësin për një jetë të mrekullueshme. Në të vërtetë nuk patëm motivim, ndonëse vazhdimisht i premtomim vetes, që të realizonim nivelin e manager-it.

Deri sa erdhi Porçi në 2011, ku Róbert Varga na detyroi...

Po, fjalë për fjalë. Secili duhet të merrte përsipër një nivel. Pashë nëpër fytyra peshën e përgjegjësisë, se si merrnin përsipër dhe thoshin kufirin kohor. Kjo kishte një domethënie të madhe, sepse e gjithë kjo u zhvillua përpara drejtuesve, dhe u botua edhe në revistën e Forever-it. Ne morrëm përsipër, që e shumta deri në gusht të 2012-ës, por më mirë deri në janar do të bëhemi manager-ë.

Si punuat?

Për ne ishte i mirë sistemi ABC; ligji i numrave të mëdhenj funksionon. Nuk ishte e lehtë, por atë që njerëzit nuk e bëjnë për vite, në raste të veçanta janë të aftë ta përfundojnë brënda 45 ditëve. Mësim për mua është, që duhet vetëm një objektiv me afat kohor, dhe atëhere bën gjithshka, që ta arrish: në 31 dhjetor 2012 u bëmë manager-ë.

Ku do t'ju çoj më tej vrrulli?

Edhe ne na kapi ndjenja e euforisë: u bëmë, e realizuam! Me këtë në përgjithësi për një periudhë kohe ka pak humbje të fokusit, prandaj menjëherë duhet të gjejmë objektiv të ri, që të mos rrëzohet e gjithë ajo që ngritëm. Para dhjetë vjetësh as nuk e dija se si mund të bëhet gjysëm pike, tani, në periudhën e klasifikimit për manager, midis dy festave na mungonin 14 pikë, vetëm luajtëm dorën: kjo është kollaj fare. E pabesueshme se sa ndryshon mënyra e të menduarit tek njeriu.

Një nga stacionet e zhvillimit ishte, që arritët nivelin e manager-it. Çfarë ndryshimesh kaluat në dhjetë vitet e fundit, që u solli këtu?

Shumë thonë, që ke atë biznes që meriton, atë, të cilën reziston mentalisht. Poreçi, tek unë vendosi shumë gjëra në vendin e duhur, me mikun tim Gábor Oláh senior manager u konsultova shumë, dhe edhe ai më ndihmoi që të kuptoj atë, që duhet të përballem me vendimet e mija; suksezi varet vetëm nga unë.



Gjithkush TY TË DO!

Pak me vonesë por me një respekt të përjetshëm falnderoj krijesën më të mrekullueshme të botës, Gratë. Këta vitet e fundit është bërë si gjë e zakonshme që afrimi i pranverës të ketë tre lajmëtarë: ditën e gruas, kthimin e dallandysheve dhe fillimin e sistemit MLM fringo të ri. Dy të parat gjithmonë i kam pritur me emocion, ndërsa i treti me të papritura, që gjithë jetën e kemi dashur por që më në fund, sipas tyre, ka mbërritur. Ju që jeni akoma të rinj në botën e Foreverit, ambjentohuni me mendimin, madje pranoni komplimentat që edhe shumë firma të tjera do tju kërkojnë. Dihet, që ndërtimi i tregut apo në fushën e marketingut në rrjet, bashkpunëtorët, partnerët dhe menaxherët e kompanisë botërore Forever, janë më të mirët në botë. Këto janë fakte, janë rezultate të prekshme dhe të garantuara.

Tre miliard xhiro vjetore, rreth 35 vjet rritje e vazhdueshme në më tepër se 150 vende të botës, 15 vjet stabiliteti të vazhdueshëm në rajonin e Hungarisë dhe të Ballkanit, me qendrat e veta të prodhimit Forever, me drjtorira, qendra trainimi, dhe magazinat e veta. Me prezencën e studjuesve të çmimit Nobel dhe me disa mijra mjekë, me mbi 200 lloje produktesh të veçanta dhe të nivelit botëror, me dëshmi cilësie nga më të lartat dhe më të rëndësishme të shkallës ndërkombtare dhe të vendit; me të ardhura bazë Euro të paraplanifikuara dhe të llogaritshme, me një sistem shpërblimi dhe të drejte autori, që nuk janë vonuar kurrë qoftë edhe një ditë. Kjo është Foreveri.

Në qoftë se je i bindur me gjithshka u përmend më lart dhe jo vetëm me emrin Forever, dhe do të marrësh oferta edhe nga firma të tjera atëherë mendoju mirë! Kush janë ata që të kërkojnë?.

Mund të jenë firma me një dy vjet të shkuara serioze. Si ato edhe 10 a 20 mini firma të tilla, që me disa produkte „sensacionale”, nuk të shkaktojnë gjë, që mund të jenë provuar qoftë edhe vetëm një viti dhe që sigurisht edhe pa faturë mund të mbuloohen në portobagazhin e veturës.

Firma të mëdha autoritare të sistemit MLM, dhe provuesit e rinj të vegjël, të cilë mund të kenë edhe ndonjë produkt të tyre, bashkë me ofertat e tyre në sistemet MLM on-line, „pararendësit e mëdhenj me modernë” i konsiderojnë „të vjetëruar”. Por ne duhet të kërkojmë ata që „kanë bërë revolucion” dhe që na çlirojnë nga „ëndërrat e frikshme” si: „nuk duhet folur me të njohurit, nuk ke nevojë për trajnim, nuk duhet të shesësh asgjë, nuk do të duhen materiale informuese, nuk të duhen takime apo lista emërore, dhe ti vetëm me disa klikime në linjat e internetit brënda një kohe të shkurtër mund të bëhesh milioner”. Nga kjo ata nuk kanë fare dobi, e bëjnë vetëm për ty, sepse e dinë ” sa të kënaqur ka tashmë nga shumë MLM, „ku ke punuar shumë por ske kuptuar asgjë””. Tek ata nuk ka produkte të prekshme, aq më tepër nuk ka mundësi. Të ardhurat prrallore në kartën tënde bankare do të vijnë nga vende të panjohura. Kjo është më e shpejta, më e thjeshta por edhe „më modernja” nga sipërmarrja legale me tatime. Parat e tua mund ti investosh në shumë gjëra, e rëndësishme është që „ti të jesh i pari”. Mund të marrësh gjithshka, për ditlindjen e shoqes tënde një sistem binar, mundet me oksigjenin tënd virtual, me bioksidin e karbonit 3 dimensional. Ai që do të lidhej fund, apo 2-3 muaj më vonë, të mos e bëjë. Ai vetëm monoksid qymyri do ti takojë.



Tibor Radóczy
Drejtor rajonal - Soaring Menaxher



DRAGI KEDVES ÚJ SASOK! DRAGI NOVI ORLE!
DRAGI NOVI ORLI! NOVI KEDVES
POŠTOVANI NOVI ORLE!

GLOBAL RALLY HAWAII 2013

HAWAII
GLOBAL RALLY
2013
21-29 APRIL



FOREVER 
The Aloe Vera Company



Lista jote emërore

TË JETË E GJITHË BOTA

TIBOR LAPICZ DHE ORSOLYA LENKÓ LAPICZNÉ SOARING MENAXHERË

Jeni nga Salgótarjáni – por kjo për Forever-in nuk ka shumë lidhje. Mendoj se, si soaring manager i keni kaluar tashmë kufijtë e qarkut dhe të vendit në ndërtimin e biznesit.

Tibor: Në realitet rezidencën e kemi në Salgótarján. Atje jetojmë, nga andej filloi gjithshka. Kemi shumë menaxherë bashkëpunorë në qarkun e Nógrád-it, por punojmë edhe me menaxherë të mrekullueshëm në Szombathely dhe Szlováki. Personalisht kemi ndihmuar deri tani pesë familje që të arrijnë këtë nivel biznesi.

Ky lloj ndërtimi ishte i vetëdijshëm?

Tibor: Jo, ndoshta tek ne vetëdija shfaqet në ndërtimin me efektivitet të biznesit. Kjo prandaj është në përpjekjet tona, që njerëzit të fitojnë shumë, dhe të ndjehen mirë. Nëse ndodh kështu, atëherë edhe ne jetojmë mirë. Punojmë me plan, por nuk mund të parashikohet, se cili menaxher sa do të jetë i suksesshëm, ose e thënë ndryshe: i uritur. Mjaftohet me një të ardhur mujore prej treqind mijë forintash, apo do të fitojë të themi një milion.

Orsolya: Kur na kërkuan Sándor Tóth dhe Edina Vanya, me rekomandimin e sponsorëve tanë të më vonshëm, (të cilëve do tu jemi përherë mirënjohës, që menduan për ne) Beáta Dánffy Vanyáné dhe László Vanya, i gjithë qëllimi im ishte të fitoja disa dhjetra mijë forinta krahas GYES-it. Pastaj kur kjo u realizua, e besuam, që mund të fitohet edhe dyqind-, treqind-, bile edhe pesëqind mijë forinta. Në botën e sotme shumica e njerëzve në këtë mënyrë mendon: nuk fillon ndërtimin e biznesit për milionat, por me shpresën për të shtuar pak të ardhurat. Pastaj sigurisht e shikon, që kjo gjë funksionon, dhe nga ky moment suksesi nuk varet nga ajo, që „a di”, por nga ajo që „a do”?

Tibor: Kështu është, kushdo që ka dëshirë mund ta bëjë. Këtë e provova edhe në veten time. Kjo është një sipërmarrje e tillë, në të cilën njeriu mund të arrijë gjithshka, nëse dëshiron, edhe materialisht, edhe nga çdo pikpamje tjetër.

Ju kujtohet akoma periudha e parë?

Orsolya: Të gjitha minutat. Kur më kërkuan mua, as nuk e kisha idenë e ndërtimit të rrjeti. Pak edhe u friksova, por dëshira për mirëqënie ishte më e madhe, se frika. Nuk guxoja ti thosha bashkëshortit, kisha frikë, se mos mbante qëndrim negativ, nuk do të më përkrahte dhe do të më bënte të hiqja dorë, dhe kështu edhe ndodhi. Por edhe këtu ishte e vërtetë, si në përgjithësi: në kokën e njeriut deri atëherë ka mendime, për aq kohë sa nuk e di, për se bëhet fjalë, për fakte vetëm më pas mund të flitet. Por kur mendimi i Tibit u shndrrua në fakt, ishte ai, që e filloi punën me tërë fuqitë, ndërsa unë si spektator i qetë u tërhoqa në prapaskenë, dhe vetëm pas dy vjetësh fillova, si partner me të njëjtin nivel, që ndërton biznesin.

Tibor, kush solli ndryshim në kokën tënde?

Tibor: Tek unë faktorë frenues ishin paragjykimet dhe egoizmi. Kisha takuar shumë njerëz, që merreshin me ndërtim rrjeti, dhe e përgjithësova opinionin e krijuar për ta, gabimisht kisha një përvojë të madhe me produktet. Pika që ndryshoi qëndrimin tim ishte ajo, kur ju përgjërëva Sanyit, që të më tregonte bonusin e llogaritur, që të shikoja me sytë e mi dëshminë, se sa mund të fitohej në muaj. Në letër ishte një shumë prej shtatë numrash, dhe nuk fillonte me njëshin.



**NUK I BËJNË STIVË MENAXHERËT,
POR EDHE KËSHTU JANË TË
QETË. PËR TIBOR LAPICZ DHE
ORSOLYA LENKÓ LAPICZNÉ
MË E RËNDËSISHME ËSHTË,
QË MUND TË KRENOHEN PËR
BASHKËPUNTORËT E TYRE, DHE
VAJZA E TYRE PËR ATA. PRANDAJ,
NDËRKOHË FITUAN EDHE PAK
PARA...**

Sponsor: László Vanya dhe Beáta
Dánffy Vanyáné

Linja e sipërme: Sándor Tóth dhe Edina
Vanya - Edina Balogh dhe Tamás Süle,
Miklós Berkics , József Szabó, Rolf Kipp,
Rex Maughan





Sa kohë i kushtuat „punës së re dytësore“ krahas punës?

Tibor: U morrëm tre ditë në javë nga dy orë.

Me këtë intesitet për sa kohë çfarë rezultat mund të arrihet?

Tibor: Brenda dy muajve arritëm nivelin e Supervisorit, brenda gjashtë muajve Asistant Menaxher, pas dhjetë muajsh ishim menaxherë, dhe brenda njëzet e dy muajve Senior Menaxherë. Ndërsa pas arritjes së nivelit të Asistant Menaxherit e shita sipërmarrjen time, e lashë vendin e punës, sepse atëhere e pashë dhe e provova, që me një mundësi të tillë fitimi parash kaq të llogaritëshme, dhe stabilë nuk isha takuar ndonjëherë.

Ishte vendim i vështirë?

Tibor: Jo. Isha drejtues i punësuar në një firmë shtypshkronjash, dhe krahas saj kisha një sipërmarrje private reklame. Çdo ditë ngrihesha në katër e gjysëm, dy orë bënja sport, në tetë filloja punën dhe e përfundoja në mesnatë. E krahas saj u angazhova me Forever-in. Në vendim tim të punës së atëhershëm rroga ishte 75 mijë forinta, nga sipërmarrja ime kisha miliona forinta të ardhura, por për fat të keq fitim i pastër mbetej vetëm disa qindra mijë forinta, ndërsa këto i qarkulloja përsëri për zhvillimin e sipërmarrjes. Nga ana tjetër në Forever pas gjysëm viti mundëm të llogarisim të ardhura prej treqind mijë forintash, dhe e gjithë kjo me shumë më pak kohë se ajo që investoja në sipërmarrjen time.

Mendoj, që për një rezultat të tillë duhej shumë punë.

Tibor: Kjo është e kuptueshme. Por po të krahasojmë këtë veprimtari me atë të një firme tjetër, do të shohim, që sa më shumë njerëz të punojnë atje, aq më e madhe është detyra, përgjegjësia dhe aq më shumë investim parash kërkon, që firma të funksionojë. Këtu është pikërisht e kundërta. Këtu, nëse dikush arrin, më saktë ndërton nivelin e menaxherit – ku mund të fitojë katërqind-pesëqind mijë forinta – më pas rritet më tej dhe do të ketë më shumë menaxherë, vetë ai nga kjo nuk do të ketë më shumë punë, bile mund të ketë gjithnjë e më pak, sepse rrjeti e rrit automatikisht veten, nëse drejtuesit e tij janë të motivuar. Pamvarësisht sa kohë je në biznes tre muaj apo dy vjet, gjithmonë është e njëjta gjë: ndërtim në thellësi, zgjerim dhe prodhim i xhiros.

Orsolya: Kjo punë bëhet gjithnjë e më e dashur, sa më shumë

